



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Nr.1597/ 523/ 43 regjistri, datë 19./ 20.11.2014.

Nr.144 vendimi, datë 24.2.2016.

V E N D I M
NË
“EMËR TË REPUBLIKËS”

Unë Ahmet JANGULLI/ GJYQTAR në gjykatën administrative të shkallës së parë Shkodër, në Shkodër në datën **24.2.2016**, shqyrtova në seancë përgatitore çështjen administrative nr.1597/ 523/ 43 akti, që u përket palëve :

Paditëse :

Shoqëria EDRA - 06 sh.p.k., e identifikuar me Nipt in K77421001S, me seli Shkodër Shkodër SHKODËR Lagjia “Naïm Gjylbegu”, Rruga “Fahri Ramadani”, përballë shkollës së mesme “Oso Kuka”, me status Aktiv.

Me përfaqësues ligjor Galini Shpuza (ekstrakti i QKR së, akti në fashikull).

Me prokurën e përgjithshme me nr.4940 rep, e me nr.3467 kol datë 4.9.2015, ka emëruar si përfaqësues zj. Mimoza Fishta, e njohur me letërnjoftimin me nr.028736719 e me nr. personal G96127077R (tagër përfaqësimi me cen. për llogari të tagrave që janë dhënë, pasi këtu bëhet fjalë për të drejta që posedohen etj. që nuk lidhen me padinë objekt gjykimi). Për padinë objekt gjykimi në aktet e paraqitura është edhe prokura e posaçme me nr.2767 rep, e me nr.2092 kol datë 13.6.2014, që ka emëruar si përfaqësues zj. Mimoza Fishta, të njëjtën përfaqësuese, akt i cili mund të shfrytëzohet si i tillë, por jo prokura e përgjithshme (...).

E paditur :

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër.

E përfaqësuar në gjykim, me shkresën nr.9779 prot datë 1.12.2014, nga juristja zj Sirjana Bakushi, e njohur me letërnjoftimin me nr.024589376 e me nr. personal H75426117F.

Objekti :

1. Per shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ;
Njoftim vlerësimi per detyrime tatimore, nr.2918/1 prot datë 4.5.2011 dhe shfuqizimin tërësisht të tyre.
Njoftim vlerësimi per detyrime tatimore, nr.8114/20 prot datë 24.11.2008, nxjerrë nga pala e paditur në dëm të palës paditëse dhe shfuqizimin tërësisht të tyre.

Njoftim vlerësimi per detyrime tatimore, nr.2729/4 prot datë 15.5.2010, nxjerrë nga pala e paditur në dëm të palës paditëse dhe shfuqizimin tërësisht të tyre.
Njoftim vlerësimi per detyrime tatimore, nr.342/32 prot datë 21.1.2009, nxjerrë nga pala e paditur në dëm të palës paditëse dhe shfuqizimin tërësisht të tyre.
Detyrimin për palen e paditur që të ndalojë marrjen e masave të mëtejshme lidhur me këto akte administrative.



B. Ligjore :

Nenet 31 e 32 të Kodit të Procedurës Civile, nenet 115/a, 116/c, 118/2 dhe 119 të K.Pr.Administrative, Nenet 7, 15, 17 a, e të ligjit nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

Gjatë gjykimit, në mungesë të palëve, ku pala paditëse ka paraqitur një kërkesë me shkrim për heqje dorë nga gjykimi, e si shqyrtova aktet shkresore në tërësi.

KONSTATOVA

I.

1. Se, pala paditëse ka vënë në lëvizje gjykatën me padi/ duke pretenduar sipas objektit.

1.1. Padia është regjistruar *pa u paguar* shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.

II. Rrethanat e faktit:

2. Palët me njeri tjetrin, janë në një konflikt, për veprimet administrative të kryera gjatë mbajtjes së aktit administrativ (për të cilin nuk është ushtruar ankim administrativ).

2.1. Pala paditëse ka vënë në lëvizje gjykatën me padi/ duke pretenduar sipas objektit të mësipërm, duke paraqitur para gjykatës/ **padinë e mësipërme** (bëhet fjalë për padinë e paraqitur për regjistrim), dhe duke i bashkëngjitur asaj/ aktet shkresore përkatëse (aktet në fashikull).

2.2. Padia është hartuar në katër fletë formati A-4, duke e filluar padinë si person juridik dhe duke e përfunduar e nënshkruar atë nga përfaqësuesi ligjor i palës paditëse; duke i hequr mundësinë gjykatës, për t'a marrë në shqyrtim (për më tepër, aktet në fashikull).

2.3. Pala paditëse/ është paraqitur para gjykatës, duke kërkuar:

"1. Per shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ;

Njoftim vlerësimi per detyrime tatimore, nr.2918/1 prot datë 4.5.2011 dhe shfuqizimin tërësisht të tyre.



Njoftim vlerësimi për detyrime tatimore, nr.8114/20 prot datë 24.11.2008, nxjerrë nga pala e paditur në dëm të palës paditëse dhe shfuqizimin tërësisht të tyre.

Njoftim vlerësimi për detyrime tatimore, nr.2729/4 prot datë 15.5.2010, nxjerrë nga pala e paditur në dëm të palës paditëse dhe shfuqizimin tërësisht të tyre.

Njoftim vlerësimi për detyrime tatimore, nr.342/32 prot datë 21.1.2009, nxjerrë nga pala e paditur në dëm të palës paditëse dhe shfuqizimin tërësisht të tyre.

Detyrimin për palën e paditur që të ndalojë marrjen e masave të mëtejshme lidhur me këto akte administrative.” (objekti i padisë): “Asnjë lloj kërkimi konkret” (arsyetimi i padisë): dhe,” 1. Per shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ;

1. Njoftim vlerësimi për detyrime tatimore, nr.2918/1 prot datë 4.5.2011.

2. Njoftim vlerësimi për detyrime tatimore, nr.8114/20 prot datë 24.11.2008, shfuqizimin pjesërisht të aktit administrativ;

3. Njoftim vlerësimi për detyrime tatimore, nr.2729/4 prot datë 15.5.2010,

4. Njoftim vlerësimi për detyrime tatimore, nr.342/32 prot datë 21.1.2009, dhe

5. shfuqizimin tërësisht të tyre, duke detyruar palën e paditur që të ndalojë marrjen e masave të mëtejshme lidhur me këto akte administrative.” (kërkimi në fund të padisë).

2.3.1. Në kërkimin që trajton padia e mësipërme, me atë objekt padie, me parashtrimin në arsyetimin e saj, dhe me kërkimin e konkluduar që trajton padia, nuk mund të konceptohet se çfarë po kërkon pala paditëse, në raport me veprimet administrative të kryera nga pala e paditur, duke konsideruar ligjin procedural (ligjin nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe k.pr.civile), dhe praktikën e unifikuar gjyqësore (vendimet e njësuara nr.3 datë 6.12.2013, nr.4 datë 10.12.2013 dhe nr.3 datë 28.4.2014 të kolegjeve të bashkuara të gjykatës së Lartë).

3. Çështja (padia) është paraqitur për gjykim në datën 19.11.2014. Në zbatim të ligjit procedural civil – administrativ/ gjykata ka vendosur që të regjistrohet padia e bashkë me regjistrimin të paguhet edhe taksa mbi aktet e shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.

4. Në datën 16.2.2016/ çështja ka kaluar për veprime përgatitore, duke thirrur edhe palët për t’i dëgjuar.

4.1. Në veprimet përgatitore/ në seancën e datës 16.2.2016, kërkesëpadia i është kthyer palës paditëse për t’a plotësuar atë në elementët e saj, sipas vendimit kthim për plotësim të datës 16.2.2016/ duke i lënë një afat kohor prej 10 ditësh, dhe për këtë arsye u ndërpreu veprimet përgatitore. Në këtë vendimmarrje gjykata ka qenë në unison të plotë edhe me vullnetin e palës paditëse, “duke gjetur mirëkuptim në orientimin që u dha nga gjykata në seancë/ e në kohën që u la për të plotësuar padinë në të metat e saj” (për më shumë p-v i seancës, e vendimi kthim për plotësim).

5. Në datën 23.2.2016 (nëpërmjet kancelarisë), pala paditëse ka paraqitur një kërkesë me shkrim për heqje dorë nga gjykimi.

5.1. Në rrethanat e mësipërme, çështja ka kaluar përsëri për veprime përgatitore, pa i thirrur palët për t’i dëgjuar.

III. Vlerësimi i gjyqtarit:

6. Në këto rrethana, e çmova se, duhet vendosur pushimi i gjykimit të çështjes.

Sa sipër provohet me aktet shkresore dhe gjithë dokumentacioni në dosje.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 158 gërma a § 1 e 9/ për nenin 299 gërma b)/ për nenin 201 § 1 të k.pr.civile, dhe nenit 39 pika 3 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar.

V E N D O S A

Pushimin e gjykimit në çështjen administrative nr.1597/ 523/ 43 akti, datë 19/ 20.11.2014, që është ngritur nga pala paditëse shoqëria EDRA - 06 sh.p.k., për shkakun se hoqi dorë nga gjykimi.

Shpenzimet gjyqësore t'i ngarkohen *palës paditëse* shoqëria EDRA - 06 sh.p.k..

Kundër këtij vendimi lejohet *ankim i veçantë*, në gjykatën administrative të apelit Tiranë.

U shpall në Shkodër me 24 shkurt 2016.

Shpenzimet gjyqësore:


Njoftime 300 lekë.

Akte – Letër 50 lekë,

Shuma: 350 lekë.

Sekretare
Entela HASMUJAJ

EH



VERTETOHET SE VENDIMI KA MARRË FORMË TË PRERË

SOT ME DATË 26.04.2016

